



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 4 Datë 22.01.2020

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	BASHKIA LIBOHOVË
Organi auditues	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Numri i procedurave të audituara	10 (dhjetë)
Lloji i procedurës/ave të audituara	Procedurë "E hapur" : 4 (katër) Procedurë "Kërkesë.për propozim" : 6 (gjashtë)
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk vijnë në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, në procedurat e prokurimit të audituara. 2. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorëve pjesëmarrës, në procedurat e prokurimit të audituara. 3. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, pasi nuk ka kërkuar sqarime lidhur me elementët përbërës të dy ofertave anomalisht të ulëta, të paraqitura në një nga procedurat e prokurimit të audituara.
Masat e marra	Në bazë të nenit 13, pika 2/i dhe nenit 72, pika 1/gj/i/j, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 8 persona dhe t'i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, masë disiplinore ndaj 1 personi, të evidentuar përgjegjës, për mospërmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenet 46, 53 dhe 56 të këtij ligji.